



**Universiteti i  
Tiranës**



**Universiteti i  
Prishtinës**



**Universiteti  
Shtetëror i Tetovës**



**Kolegji AAB**  
CILËSI. LIDERSHIP. SUKSESI!

**Kolegji AAB**

## **THIRRJE PËR PJESËMARRJE**

### **KONFERENCË NDËRKOMBËTARE**

# **“SFIDAT E ZHVILLIMIT NË NJË SHOQËRI QË NDRYSHON: GJETJE NGA STUDIME ME ADOLESHENTË DHE TË RINJ”**

**2-3 DHJETOR 2016**  
Fakulteti i Shkencave Sociale  
Universiteti i Tiranës  
Tiranë, Shqipëri

**Në bashkëpunim me:**

Universitetin e Prishtinës, Kosovë

Universitetin Shtetëror të Tetovës, Maqedoni

**Të ftuar:**

PROF. EMERITUS, PHD. CHRIS EVANS

ASSOC.PROF, PHD. RADOSVETA DIMITROVA

Shoqëria shqiptare në këto dekada të fundit po përballet me sfida të mëdha e të ndjeshme në të gjitha aspektet. Ndryshime të dukshme në nivelet makro dhe mikro kanë një impakt të pashmangshëm në drejtimin që zhvillohet individi. Ndryshimet e ndryshme dhe të shpejta sociale, kulturore, teknologjike, ekonomike dhe demografike të viteve të fundit paraqesin sfida të reja dhe ofrojnë mundësi të reja për adoleshentët dhe të rinjtë. Adoleshenca dhe rinia janë faza të jetës që karakterizohen me ndryshime intensive. Megjithatë, si ndryshon vetë natyra e adolehencës dhe e rinisë? Kur kontekstet sociale bëhen në thelb të ndryshme, a çon kjo në një transformim rrënjësor të proceseve të zhvillimit social dhe psikologjik të adolehentëve dhe të rinjve? Individët që përjetojnë këto ndryshime shoqërore përfaqësojnë një fokus të veçantë për studiuesit, të cilët ofrojnë evidenca empirike në vëmendjen e zhvillimit profesional dhe akademik. Ndaj, ju ftojme të ofroni kontributin tuaj shkencor në këtë konferencë.

### **Komiteti Shkencor:**

Prof. Dr. Edmond Rapti (UT)

Prof. Dr. Adem Tamo (UT)

Prof. Dr. Theodhori Karaj (UT)

Prof. Dr. Nikoleta Mita (UT)

Prof. Asoc. Dr. Ariliza Arënliu (UP)

Prof. Emmeritus, Phd. Chris Evans

Assoc. Prof. PhD. Radosveta Dimitrova

Prof. Dr. Myqereme Rusi (UT)

Prof. Asoc. Dr. Zamira Hyseni (UP)

Dr. Ibrahim Naziri (UT)

PhD. M.D. Mimoza Shahini

### **Komiteti Organizativ:**

Prof. Dr. Theodhori Karaj

Prof. Asoc. Dr. Artemisi Shehu;

Dr. Eglantina Dervishi

Dr. Skerdi Zahaj;

Dr. Albana Canollari (Baze)

Dr.sc. Merita Shala, PhD

### **Tematikat e Konferencës:**

**Tematika 1:** Impakti i faktorëve kulturorë në zhvillimin e adolehentëve dhe të rinjve

**Tematika 2:** Impakti i faktorëve komunitarë në zhvillimin e adolehentëve dhe të rinjve

**Tematika 3:** Roli i edukimit në zhvillimin e adolehentëve dhe të rinjve

**Tematika 4:** Roli i familjes dhe prindërimit në zhvillimin e adolehentëve dhe të rinjve

**Tematika 5:** Shëndeti mendor i adolehentëve dhe të rinjve

## Udhëzime për aplikantët:

Ju falenderojmë për interesin tuaj për t'u angazhuar në këtë konferencë ndërkombëtare.

Ju lutemi ndiqni hapat e mëposhtëme për të garantuar pjesëmarrjen tuaj!

1. Përzgjidhni një tematikë në të cilën dëshironi të merrni pjesë.
2. Dorëzoni abstraktin në anglisht dhe në shqip (Times Roman, 12), në adresën që vijon: [fshs.dpp2016@gmail.com](mailto:fshs.dpp2016@gmail.com).  
Data e caktuar 1 Nëntor, 2016. Abstraktet nuk duhet të kalojnë 300 fjalë.
3. Ju duhet të merrni një konfirmim brenda 10 ditëve.
4. Ju lutem kini parasysh se vetëm abstrakte që prezantojnë studime empirike do të merren në konsideratë për aprovim.
5. Kordinatorët do t'ju kontaktojnë për procesin e regjistrimit.

<b>FORMATI I ABSTRAKTIT</b>	
<b>TITULLI I STUDIMIT</b> <i>(14 points Times New Roman, Bold, Centered)</i>	
<b>Emër Mbiemër i Autorit*</b>	(12 Points Times New Roman)
<b>Emër Mbiemër i bashkautorit**</b>	(12 Points Times New Roman)
<b>*Institucioni përfaqësues dhe adresa e emailit të autorit</b>	(12 Points Times New Roman)
<b>**Institucioni përfaqësues dhe adresa e emailit të bashkautorit</b>	(12 Points Times New Roman)
<b>Abstrakti</b>	(150-300 fjalë) (12 Points Times New Roman, Justified, Single-space)
<b><i>Fjalët kyçe:</i></b>	<i>(3-6 fjalë) (12 Points Times New Roman, Italicize Each Word)</i>

**Në pritje të takimit me ju në Tiranë- Dhjetor 2016!**